

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Publikohet lista e Kosovës
ADRESA	https://www.koha.net/futboll/publikohet-lista-e-kosoves-ftohet-osmani-i-bayernit
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 01:17:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 12:03:47 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2be98bd9539f8d248f937f0dfa7e93e03ef778fe0fa2e8156081b2147de25702
TEKSTI	eb1c51b469714ed12aefdcf0551fdfa9f8a96a720a84bd5c4fc70d957f34624c
PAMJA	56f33f11d0659ccdc86bbb5414325628035a64aad5357b3d8cf39a1680b70149

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	db7c867b23736956f4cf5259ba3c03e951088792659cd7a3468c37edd1e32966
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9820c0ddeb45471f928207a963ca36ba3aaf52dec6ebed920f8d826671ee6c4b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/db7c867b23736956f4cf5259ba3c03e951088792659cd7a3468c37edd1e32966>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FUTBOLL

Publikohet lista e Kosovës, ftohet Osmani i Bayernit

12 o. më parë

Terhiqet edhe Fidan Aliti

12 o.

Beris



18 shtator 2026 14:03

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përgjdhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Përzgjedhësi i Kosovës, Franco Foda, ka publikuar të premtën listën e lojtarëve të ftuar për ndeshjet e para të edicionit të ri të Ligës së Kombeve. Në listë nuk është kapiteni i deritashëm, Amir Rrahmani, që ka vendosur të largohet nga ekipi përfaqësues i pakënaqur me drejtuesit e FFK-së.

Janë ftuar Edon Zhegrova e Milot Rashica.

Ndërkohë ka edhe emra të rinj.

Lojtar i ri i Kosovës është talenti i madh i Bayernit, Erblin Osmani. 17-vjeçari ka luajtur për U16 e U17 të Gjermanisë. Dhe ka vendosur të luajë tash e tutje për Kosovën A.

Dion Kacurri është tjetër emër i ri. 22-vjeçari ka luajtur për Zvicrën U21. Karrierë bënë tek Austria Lustenau në Austri.

Kosova luan me Irlandën më 24 shtator në Prishtinë.

Më 27 shtator "Dardanët" përballen në udhëtim me Austrinë.

Më 1 tetor është ndeshja Izrael - Kosovë, në Debreçen të Hungarisë, ndërsa më 4 tetor, Kosova e pret Austrinë në "Fadil Vokrri".

Ndeshjet i takojnë Grupit 3 të Ligës B.

Kulturë.

"A Chip Odyssey" dekodon frymën e zhvillimit të Tajvanit

Arbëri.

Jashari: Kosova duhet të sillet si e rritur karshi Evropës dhe Amerikës

Arbëri.

Jashari: PDK-ja duhet ta ketë Ministrinë e Drejtësisë

Futboll.

Brentfordi turpëron Chelsea

LAJMET E MBRËMJES.

Bashkëpunëtorë dhe bashkëveprimtarë e kujtojnë kontributin e Flora Brovinës

Futboll.

Bayerni me fitore 7:0, Kane vendos rekord



Tërhiqet edhe Fidan Aliti

12 o. më parë / 18 sht 2026 14:20



Fidan Aliti është tjetët lojtar i tërhequr nga përfaqësuesja e Kosovës në futboll.

Letra e plotë e Halitit:

Ka momente dhe vendime që janë të vështira për t'u jetuar e për t'u marrë dhe padyshim se ky që po e publikoj sot është një nga ta.

Pas shumë vitesh, shumë ndeshjesh, emocioneve të pafundme, sakrificash e kujtimeve që do t'i mbaj me vete tërë jetën, ka ardhur koha që të mbyll kapitullin tim me ekipin kombëtar. Ta vesh fanellën e Kosovës ka qenë dhe do të mbetet një prej nderimeve më të mëdha të jetës sime. Sa herë që kam dalë në fushë me këtë fanellë, kam dhënë shpirtin e zemrën për të. Kam luajtur me krenari e përgjegjësi, i vetëdijshëm për peshën që bart përfaqësimi i vendit tonë.

Kemi kaluar shumë bashkë, festa e fitore, por edhe zhgënjimin e humbjeve. Kemi luftuar e ëndërruar, por edhe kemi shkruar bashkërisht një pjesë të ndritshme të historisë së futbollit të Kosovës.

Ndihem posaçërisht i privilegjuar që isha pjesë e një gjenerate që hapi kapitullin e Kombëtares sonë në garat ndërkombëtare dhe, bashkërisht, e rritëm Kosovën. Për këtë do të jem gjithmonë krenar.

Falënderim i madh për secilin bashkëlojtar me të cilin kam ndarë zhveshtoren, për trajnerët dhe stafin e tyre, për Federatën e Futbollit të Kosovës, për tifozët që ishin me ne, si dhe për të gjithë ata që na kanë qëndruar pranë.

Por, një falënderim i veçantë shkon për familjen time. Për gruan dhe djalin tim, për prindërit dhe të gjithë ata që ishin pranë meje me dashuri e përkrahje. Ju keni qenë forca ime kryesore në këtë rrugëtim.

Sot po largohem nga Kosova si futbollist, por kurrë si tifoz i saj. Kosova është dhe do të jetë gjithmonë pjesë e imja. Është dhe do të jetë gjithmonë e para, sa herë që të ketë nevojë për mua.

Falemideit për gjithçka, Kosovë.

Ishte ëndërr, u bë nder dhe krenari!

Berisha i jep fund karrierës me Kosovën

12 o. më parë / 18 sht 2026 14:18



Foto: FFK

Mesfushori Valon Berisha i ka dhënë fund karrierës me Kosovën.

Këtë e bëri të ditur FFK të premten.

Letra e plotë e Berishës:

"Nuk e di nëse ekzistojnë fjalët e duhura për ta nisur një shkrim si ky. Në fakt, nuk po di as se si ta nis një shkrim, që bart me vete aq shumë krenari e emocion, që fjalët nuk mjaftojnë për ta treguar.

Sot, kur po i shkruaj këta rreshta, kam para syve të mi një djalë shqiptar që po rritej në mërgim me dy ëndrra në jetën e tij: Kosovën dhe futbollin. Një familje, dy prindër, që atij djali ia ngulitën thellë në shpirt e në mendje dashninë dhe obligimin për familjën, për gjakun e tij, e mbi të gjitha për Kosovën e shtrenjtë. Sot, shumë vite më vonë, jam i mbushur me krenari dhe falënderim ndaj familjes, prindërve dhe Zotit që më mundësoi t'i përmbush të dyja këto ëndrra. Që me një top futbollit ta lartësojë emrin e Kosovës.

Pas shumë vitesh, 52 ndeshjesh dhe disa golash, njëri prej të cilëve, ai kundër Finlandës, do të mbetet përgjithmonë në historinë e futbollit të Kosovës, sot ka ardhur koha që periudha ime si futbollist aktiv me Kombëtaren të përfundojë.

Dhjetë vite më parë mora një prej vendimeve që do të më bëjë krenarë tërë jetën. Pavarësisht falënderimit që kam për Norvegjinë, shtet që, mua dhe familjës sime na dhanë mundësinë nër ietë më të mirë. nor e lash dhe atëherë vendosa t'i hashkohem

Kosovës, sepse ndjeva fuqishëm thirrjen e brendshme për ta përfaqësuar gjakun që më rrjedh në vena dhe për t'i bërë krenarë prindërit e mi.

Vendosa të tregoj se Kosova është mbi çdo gjë dhe, bashkë me shokët e gjeneratës, ndërtuam rrugën e Kombëtares sonë, me shpresën që të rinjtë e sotëm ta vazhdojnë, ta besojnë dhe të jenë të bashkuar për t'i arritur synimet e mëdha.

Bashkë jetuam shumë momente të mira e gëzime, festuam pa mbarim fitoret tona, por edhe qëndruam të bashkuar në humbje të rënda.

Dy herë ishim shumë afër ëndrrës së madhe. Nuk e arritëm, por dhamë gjithçka nga vetja.

Prandaj, dua t'i falënderoj të gjithë bashkëlojtarët, trajnerët, stafin e tyre, Federatën e Futbollit të Kosovës, të gjithë njerëzit që punuan rreth ekipit dhe tifozët tanë, Dardanët.

Nga sot e tutje, nuk do të jem më në fushë për ta mbrojtur këtë fanellë.

Por do të jem gjithmonë përkrahës, në çdo ndeshje, në çdo gol, në çdo fitore e në çdo ëndërr tonën.

Sepse, kur, një herë e ke veshur këtë fanellë, ajo nuk hiqet më kurrë prej teje.

Nga sot e tutje edhe unë do të jem një nga miliona mbështetësit jashtë fushës.

Të dua, Kosova ime!!!!".

Dhjetë lojtarë në listën rezervë

12 o. më parë / 18 sht 2026 14:11



Franco Foda ka përgatitur edhe një listë të lojtarëve rezervë.

Pjesë e saj janë dhjetë lojtarë, ku përfshihen edhe emra si Meriton Korenica, Leon Frrokaj, Rilind Nivokazi e Betim Fazliji.

Këta lojtarë mund të ftohen në rast të lëndimeve apo mungesave të lojtarëve në listën bazë.

#KOSOVA

#FRANCO FODA

#LISTA

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohebt kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njëjësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzime për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.